



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.2629, datë 29.10.2015**

**Për**

**“Miratimin e përfundimit të Këshillimit Publik “Për performacën e bazës së të dhënave referencë të centralizuara për portabilitetin e numrit””**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

- |                 |          |         |
|-----------------|----------|---------|
| 1. Z. Piro      | Xhixho   | Kryetar |
| 2. Z. Alban     | Karapici | Anëtar  |
| 3. Znj. Anila   | Denaj    | Anëtar  |
| 4. Znj. Ketrin  | Topçiu   | Anëtar  |
| 5. Znj. Klarina | Allushi  | Anëtar  |

dhe sekretare Znj., në mbledhjen e datës 29.10.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Miratimin e përfundimeve të Këshillimit Publik “Për performacën e bazës së të dhënave referencë të centralizuara për portabilitetin e numrit”,**

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”;
2. Neni 110 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918 i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në republikën e Shqipërisë”*);
3. Rregullore nr. 13, datë 16.04.2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1219, datë 07.04.2010, e ndryshuar, (*Rregullore nr. 13*).

4. Vendimi nr. 2571, datë 22.05.2015 i Këshilli Drejtues i AKEP, mbi miratimin për Këshillim Publik të projektaktit administrativ “Për performancën e bazës së të dhënave referencë të centralizuara për portabilitetin e numrit”;
5. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S :**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

1. Relacioni shpjegues mbi rezultatet e Këshillimit Publik “Për performancën e bazës së të dhënave referencë të centralizuara për portabilitetin e numrit”;
2. Komentet e palëve të interesuara;
3. Projektvendim i Këshillit Drejtues të AKEP i formatuar dhe arsyetuar;
4. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe duke i’u referuar bazës ligjore të sipërcituar,

### **V Ë R E N s e :**

1. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr. 2571, datë 22.05.2015, vendosi të miratojë për Këshillim Publik projektaktin administrativ “Për performancën e bazës së të dhënave referencë të centralizuara për portabilitetin e numrit,
2. Palët e interesuara, gjatë periudhës së Këshillimit Publik kanë depozituar në AKEP komentet mbi dokumentin për Këshillim Publik “Për performancën e bazës së të dhënave referencë të centralizuara për portabilitetin e numrit” ne forme elektronike me email,
3. AKEP vlerëson se komentet e palëve të interesuara në këtë këshillim publik reflektojnë edhe qëndrimin e AKEP. Baza e të dhënave referencë e centralizuar ofrohet mjaftueshëm, funksionimi dhe teknologjia e aplikuar e CRDB ka qenë e kënaqshme, niveli i bashkëpunimit midis AKEP ofruesit të CRDB dhe operatorëve që përdorin këtë sistem ka qenë i një niveli të kënaqshëm dhe se shërbimi që ofrohet nga CRDB është gjithë përfshirës.
4. Për këtë qëllim, AKEP në zbatim pikes 4 të nenit 110 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar, Udhëzuesin e Procedurave për Këshillimin me Publikun miratuar me Vendim nr. 1183, datë 10.03.2010, si dhe në pikën 5 të nenit 10 të Rregullores nr. 13, datë 16.04.2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, çmon si të arsyeshme miratimin e përfundimeve të Këshillimi Publik “Për performancën e bazës së të dhënave referencë të centralizuara për portabilitetin e numrit”,
5. AKEP, në zbatim të nenit 110 të ligjit nr. 9918, dt. 19.05.2008 i ndryshuar, pas përfundimit të afatit për këshillim publik, duke marrë në konsiderate komentet e palëve të interesuar, publikon përfundimet e këtij këshillimi publik sipas dokumentit bashkëlidhur;
6. Gjatë diskutimeve në mbledhjen e Këshillit Drejtues në këndvështrim të dispozitave ligjore mbi portabilitetin dhe akteve të tjera rregullatore lidhur me te, u parashtrua dhe u ra dakort për nevojën e rishikimit të Rregullores nr. 13, datë 16.04.2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1219, datë 07.04.2010, e ndryshuar.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

1. Këshilli Drejtues, duke konsideruar rëndësinë e nxjerrjes së këtij dokumenti, për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike bazuar në nenin 110, 114 dhe 115 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, pikën 5 të nenit 10 të Rregullores nr. 13, datë 16.04.2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar dhe Rregulloren e Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues;

## **V E N D O S:**

1. Të miratojë përfundimet e këshillimit publik “Për performancën e bazës së të dhënave referencë të centralizuara për portabilitetin e numrit”, dhe të publikojë mendimet dhe komentet e palëve të interesuara duke respektuar konfidencialitetin e informacionit, sipas dokumentit bashkëlidhur,
2. Të fillojë procedura për rishikimin e Rregullores nr.13, datë 16.04.2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1219, datë 07.04.2010, e ndryshuar.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al);

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**

**Piro XHIXHO**

## **ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:**

1. **Alban KARAPICI** \_\_\_\_\_
2. **Anila DENAJ** \_\_\_\_\_
3. **Ketrin TOPÇIU** \_\_\_\_\_
4. **Klarina ALLUSHI** \_\_\_\_\_